



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. 82/prot
12

Koplik më: 08/01/2021

V E N D I M

Nr 86 datë 29 / 12 / 2020

PËR

”Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Luigj Shabi, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e banesës, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e këtij shtetasi nga buxheti i bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, programi për “emergjencat civile”

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit Z. Luigj Shabi, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për djegien e shtëpisë.

1. 3. T’i akordojë familjes së shtetasit Z. Luigj Shabi, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë ,nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të VKB nr 6 date 18.01.2020 për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 si dhe sipas shkresë së MFE me nr 23198 prot datë 24.12.2019, familjes së shtetasit z. Luigj Shabi, të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore,

4. T’i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit Z. Luigj Shabi, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe t’i propozojë/kërkojë mbështetje Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) , në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës

së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën financiare, për shkak të mungesës së fondeve nga ana e Bashkisë.




5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Z.Luigj Shabi, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329,datë 16.05.2012.

6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Z.Luigj Shabi**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit.


7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 536,356 (peseqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesedhjetë e gjashtë) leke. Dëmtime nga ana ndërtimore në vlerën 2.958.668 (dymilion e nenteqind e pesedhjetë e tete mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e tete) leke.
Vlera në total e dëmeve është : 3.495.024 (tre milion e katerqind e nentedhjetë e pese mijë e njezet e kater) leke.

8.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj 

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj 

Miratur me 29.12.2020

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 05.01.2021

